



UNMIK



IPVK

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHE TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL
DEVELOPMENT**

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Duke u bazuar në Rregullorën e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të datës 15 maj të vitit 2001 mbi
Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, neni 5.1 paragrafi (n) Regullorja
e UNMIK-ut No. 2001/19 të datës 13 shtator, 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të
Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, si dhe neni 22 të Ligjit Nr.
2003/9 i shpallur me Rregullorën e UNMIK-ut të datës 2003/21 qershor, 2003.

Nxjerr më sa vijon:

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 9/2004
PËR ADMINISTRIMIN DHE PROCEDURAT E VOTIMIT NË
KOOPERATIVAT E BUJQËVE**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të përcaktoj organet kryesore
administrative të kooperativave bujqësore dhe kompetencat e tyre, si dhe të përcaktoj
procedurat e zgjedhjeve dhe të votimit.

**Neni 2
Definicionet**

Libri regjistruar do të thotë regjistri i anëtarëve të kooperativës dhe numri i aksioneve
në pronësi të secilit anëtar, siç është theksuar në nenin 7.4 të Ligjit mbi Kooperativat e
Bujqëve.

**Neni 3
Organet e administrimit të kooperativës**

Kooperativa e bujqëve administrohet nga:

- a) Kuvendi i Përgjithshëm; dhe
- b) Këshilli Drejtues

Neni 4 **Kuvendi i Përgjithshëm**

4. 1 Kuvendi i Përgjithshëm është organi më i lartë i kooperativës dhe është i përbërë nga të gjithë anëtarët e regjistruar të kooperativës.
4. 2 Në Kuvendin e Përgjithshëm çdo anëtarë ka një votë përderisa nuk parashihet ndryshe me statutin e Kooperativës.

Neni 5 **Kompetencat e Kuvendit të Përgjithshëm**

5. 1 Kuvendi i Përgjithshëm:
- a) Aprovon Statutin e Kooperativës dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - b) Vendos për bashkime, likudime ose vazhdim të kohëzgjatjes së kooperativës;
 - c) Zgjedhë ose shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues;
 - d) Aprovon llogaritë vjetore, deklaratat financiare, si dhe vendos mbi shpërndarjen e tepricës vjetore;
 - e) Vendos mbi ndryshimet e kontributeve në kapital;
 - f) Aprovon planin vjetor afarist dhe buxhetin përkatës;
 - g) Aprovon raportin vjetor të Komisionit Drejtues;
 - h) Vendos mbi strukturën e mbrendshme dhe rregullat administrative të kooperativës;
 - i) Vendos mbi blerjen ose shitjen e pasurisë (përveq pasurisë së përcaktuar me dispozitat e nenit 18. 3 të Ligjit për Kooperativat e Bujqëve);
 - j) Vendos mbi huatë ose kreditet e Kooperativës;
 - k) Aprovon vlerën e kontributit në Natyrë;
 - l) Vendos mbi ankesat kundër vendimeve të Këshillit Drejtues në raste të pranimit apo të përjashtimit të anëtarëve;
 - m) Vendos mbi anëtarësimin në Union ose Fedeartë;
 - n) Verifikon zgjedhjen e përfaqësuesit për Union apo Federatë;
5. 2 Disa nga këto kompetenca mund të barten tek Këshilli Drejtues me vendimin e marrur nga shumica e anëtarëve të kooperativës.

Neni 6 **Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Përgjithshëm**

6. 1 Kuvendi i Përgjithshëm mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
6. 2 Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Përgjithshëm mbahet një herë në vitë.
6. 3 Në mbledhjen e rregullt të gjithë anëtarët duhet të ftohen më së paku dhjetë (10) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

6. 4 Ftesat nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe këto përmbajnë edhe rendin e ditës së mbledhjeve. Ftesës i bashkangjitet raporti financiar vjetor.
6. 5 Mbledhjet do të mbahen në zyrën qendrore të kooperativës mbrenda tre (3) muajve pas përfundimit të vitit fiskal.
6. 6 Kuvendi i Përgjithshëm mund të mbaj mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesën e Këshillit Drejtues ose me kërkesën e 25% të anëtarëve të regjistruar të kooperativës. Në këtë rast 25% e anëtarëve të regjistruar duhet të dorëzojnë kërkesën Këshillit Drejtues të nënshkruar me nënshkrimet e tyre individuale.

Neni 7 **Këshilli Drejtues**

7. 1 Administrimi i kooperativës bëhet nga ana e Këshillit Drejtues. Anëtarët e Këshillit Drejtues (3.5.7 ose 9) zgjedhen nga Kuvendi i Përgjithshëm. Numri i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Drejtues duhet të përcaktohet me statut të kooperativës.
7. 2 Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen për mandat prej 4 vitesh me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një madat.
7. 3 Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Drejtues mbrenda 15 dite nga dita e zgjedhjes së tyre mblidhen dhe zgjedhin me votime të fshehta Kryetarin, Zëvendës Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit Drejtues.
7. 4 Nëse anëtari(ët) i Këshillit abstenon nga mbledhjet e Këshillit për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj atëherë konsiderohet se ky anëtarë ka hequr dorë nga Këshilli.
7. 5 Në fund të mandatit të tij, Këshilli Drejtues shpall zgjedhjet e reja.
7. 6 Procedurat zgjedhore do të përshkruhen në statutin e Kooperativës.

Neni 8 **Kuorumi**

8. 1 Kuvendi i Përgjithshëm konsiderohet të jetë në kuorum nëse në mbledhje janë prezent, më shumë se 50% e anëtarëve të regjistruar me të drejtë vote. Verifikimi i kuorumit bëhet me leximin e emrave të anëtarëve nga libri regjistruar.
8. 2 Nëse nuk arrihet kuorumi, Kuvendi i Përgjithshëm mblidhet sërish mbrenda 10 ditëve me rend dite të njëjtë. Në mbledhjen e përsëritur ekziston kuorumi pavarësisht nga numri i anëtarëve prezent.
8. 3 Në rastet kur Kuvendi i përgjithshëm thirret për të vendosur mbi:
 - a) Ndryshimin e shtrirjes së kooperativës;
 - b) Bashkimin, transformimin apo shpërbërjen e kooperativës;
 - c) Ndryshimet dhe plotësimet e statutit.Kuvendi i Përgjithshëm konsiderohet të jetë në kuorum nëse në mbledhje marrin pjesë të paktën 2/3 e anëtarëve të regjistruar me të drejtë vote. Verifikimi i kuorumit bëhet me leximin e emrave të anëtarëve nga libri i regjistruar.
8. 4 Nëse nuk arrihet kuorumi, Kuvendi i Përgjithshëm mblidhet sërish mbrenda 10 ditëve me rend dite të njëjtë. Në mbledhjen e përsëritur kuorumi ekziston nëse janë prezent 50% e anëtarëve.

Neni 9
Procedurat për votim

9. 1 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe përfaqësuesit (ve) për Federatë ose organe të tjera të kooperativës mbikëqyret nga komisioni zgjedhor, i cili përbëhet nga 3 anëtarë. Anëtarët e komisionit zgjedhor, zgjedhen nga Kuvendi i Përgjithshëm.
9. 2 Komisioni zgjedhor përcakton vendin dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve dhe kujdeset që procesi zgjedhës të jetë i drejtë dhe i paanshëm.
9. 3 Anëtarët e dorëzojnë kandidaturën e tyre komisionit zgjedhor së paku 3 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.
9. 4 Zgjedhjet mbahen me vota të fshehta. Përdoret një list unike me emrat e kandidatëve në rendin alfabetik.
- 9.5 Çdo anëtarë i regjistruar ka të drejtë në një vote nëse me statutin e kooperativës nuk parashihet ndryshe. Në asnjë rast një anëtarë i regjistruar nuk mundë të ketë më shumë se dy vota
9. 6 E drejta e votës nuk mundë të ushtrohet me autorizim.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyj në fuqi nga data e nënshkrimit të tij. .

14 korrik, 2004

Prishtinë

Ministri për Bujqësi, Pylltari
dhe Zhvillim Rural

Goran Bogdanoviq
